

VENDIM
Nr. 620, datë 22.10.2021
(Ndryshuar me VKM nr.757,
date 09.12.2021)

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE, PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, GJATË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE PËR PËRBALLIMIN E PARANDALIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI I VENDIMIT

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes e furnizimit me energji elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, si dhe për parandalimin e përballimin e saj.

II. ZBATIMI I VENDIMIT

1. Ky vendim është i zbatueshëm për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në bazë të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, si dhe parashikon masa të vazhdueshme për përballimin e parandalimin e saj. Parashikimet e vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, janë të zbatueshme gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

2. Rregullorja e blerjes së energjisë, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), nuk është e zbatueshme për procedurat e blerjes së energjisë, të përcaktuara në krerët IX e X, të këtij vendimi.

III. DETYRIMI I SHËRBIMIT PUBLIK GJATË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI

Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

IV. DETYRIMI I SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT

1. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasinë e nevojshme për nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal, shoqëria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik ka të drejtë të marrë me qira asete gjeneruese termike të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë apo të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë organizon një procedurë të posaçme konkurruese, me afat të përshpejtuar për marrjen me qira të aseteve gjeneruese termike të energjisë me afat deri në

tri vite, sipas procedurave të përcaktuara në kreun VIII, të këtij vendimi. Ndërmjet Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në lidhje me sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e të gjithë klientëve universalë dhe çmimin për njësi, sipas burimit të energjisë. Shoqëria publike e prodhimit, në bazë të kontratës, lëshon ndaj furnizuesit të shërbimit publik çdo muaj faturën për koston përkatëse të prodhimit të energjisë nga burimet e veta, nga asetet e marra me qira dhe/ose blerja e energjisë.

Për efekt të këtij vendimi, Furnizuesi i Shërbimit Universal dërgon te prodhuesi publik i energjisë programe mujore, javore dhe ditore për mbulimin e kërkesës me energji elektrike për klientët fundorë. Shoqëria publike e prodhimit kryen veprime shitjeje energjie dhe depozitimi/shkëmbimi vetëm pasi plotëson të gjitha nevojat e furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

2. (shfuqizuar).

3. Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit të shitjes së prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike nga burime hidrike, me kapacitet të instaluar deri në 15 mw, në periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet.

V. ÇMIMI I RREGULLUAR PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Gjatë gjendjes së emergjencës në furnizim, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të furnizojë klientët në treg të rregulluar të energjisë, sipas përcaktimeve të nenit 109, të ligjit të sektorit të energjisë elektrike, me çmimin e rregulluar, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

VI. BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

1. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë tregton energjinë e blerë nga energjitë e rinovueshme, për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

2. Në rast të tepricave të krijuara, ato, sipas rastit, nëse ka nevojë për furnizim të klientëve fundorë, të përdoren nga Furnizuesi i Shërbimit Universal me çmimin e blerë nga prodhuesit hidrikë me përparësi të energjisë elektrike, për përballimin e nevojave të klientëve fundorë. Në rast se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal plotësohet nga shoqëria publike e prodhimit të energjisë, atëherë teprica e krijuar nga prodhuesit me përparësi shitet në treg të lirë nga furnizuesi publik në tregun e lirë.

VII. TEPRICAT E ENERGJISË SË PRODHUESIT PUBLIK TË ENERGJISË

1. Shoqëria e prodhimit publik të energjisë për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve të rregulluar kryen procedurat sipas kreut VIII, të këtij vendimi, për depozitimin e shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Për qëllime të këtij vendimi, tepricë e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë që mbetet pas furnizimit të plotë të nevojave të Furnizuesit Universal të Energjisë dhe të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

2. Shoqëria e prodhimit publik të energjisë ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cenon sasinë e nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

VIII. PROCEDURA E MARRJES ME QIRA TË ASETETEVE GJENERUESE DHE SHKËMBIMIT/DEPOZITIMIT TË ENERGJISË NGA PRODHUESI PUBLIK I ENERGJISË

1. Në zbatim të këtij vendimi, shoqëria publike e prodhimit të energjisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, fillon procedurat konkurruese për përzgjedhjen e

subjekteve që do të bëjnë depozitimin e shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike. Në përfundim të kësaj procedure ndërmjet palëve lidhen marrëveshje kuadër për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

2. Nëpërmjet këtij procesi, shoqëria publike e prodhimit të energjisë depoziton/shkëmben tepricat e energjisë të destinuara për shitje në tregun e lirë, me qëllim që:

a) të maksimizojë prodhimin e energjisë elektrike nga kaskada dhe të optimizojë përdorimin e prurjeve për prodhim, për të evituar shkarkimet e ujit pa prodhuar energji elektrike dhe duke krijuar njëkohësisht rezervë energjie për periudhën e thatë të vitit;

b) të garantojë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve kontraktore;

c) të rrisë fleksibilitetin teknik për të siguruar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik;

ç) të minimizojë dhe/ose të parandalojë ndikimet potenciale social-mjedimore.

3. Shoqëria livron energjinë elektrike për qëllime të depozitimit dhe të shkëmbimit, në rast të krijimit të tepricave pas furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe ka siguruar rezervën hidrike, sipas rregullores së menaxhimit të plotave.

4. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë merr energjinë elektrike në periudhën e thatë të vitit, me qëllim minimizimin e kostove financiare që rrjedhin nga importi i energjisë, për mbulimin e nevojave të energjisë për konsumatorët fundorë.

5. Kriteret e kualifikimit të ofruesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) subjekti ofertues të jetë i pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike;

b) subjekti ofertues të ofrojë garanci bankare për vlerën e energjisë elektrike të tërhequr për qëllime të shkëmbimit;

c) subjekti ofertues të ketë vlerë të kapitalit të regjistruar jo më të vogël se 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro;

ç) subjekti ofertues nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;

d) subjekti ofertues e administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen penalisht për shkelje penale, për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);

dh) subjekti ofertues të depozitojë pasqyrat financiare të vitit të fundit të certifikuara (pozitivisht kalueshëm dhe pa rezervë), sipas rregullave të shtetit përkatës, ku shoqëria ushtron aktivitetin;

e) shoqëria duhet të paraqesë eksperiencën e mëparshme për sigurimin e kësaj sasive energjie, edhe me kontrata afatgjata furnizimi, në masën 100% të sasisë.

6. Në rastet e tepricave të prodhimit, shoqëria publike e prodhimit të energjisë kërkon pranë palëve të kontraktuara të ofrojnë koeficientet e kthimit të energjisë elektrike që ofrohet për t'u shkëmbyer në periudhën e thatë të vitit, bazuar në kërkesën për ofertë dhe me normë kthimi të energjisë së depozituar jo më të ulët se 1 (një).

7. Çdo ofertues oferton vetëm një herë. Oferta fituese shpallen ofertat që përmbajnë koeficientin më të lartë të depozitimit dhe të shkëmbimit të energjisë.

8. Në rast se procedura e shkëmbimit rezulton e pasuksesshme, atëherë shoqëria publike e prodhimit vijon me shitjen e tepricave në treg.

9. Të ardhurat e krijuara nga shitja e tepricave akumulohen në një fond të posaçëm, i cili shërben si fond rezervë për minimizimin e riskut hidrologjik apo balancimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e ardhshme.

10. Këto të ardhura përdoren nga ana e shoqërisë publike të prodhimit, sipas nevojës, me miratim të Asamblesë së Aksionarit.

11. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertat fituese në faqen zyrtare të internetit.

12. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë për nevoja të sigurimit të gjithë energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve universalë, kryen procedurë të posaçme konkurruese

për marrjen me qira të aseteve gjeneruese termike të energjisë për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

13. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë hap procedurën konkurruese duke bërë njoftim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në website-in e saj dhe në një gazetë ndërkombëtare. Afati i hapjes së aplikimeve është jo më pak se 7 (shtatë) ditë nga botimi në gazetën ndërkombëtare.

14. Kriteret e kualifikimit të ofruesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

- a) Dokumentacioni ligjor mbi të drejtat e përdorimit apo të pronësisë së asetit gjenerues që ofrohet për dhënien me qira;
- b) Kapaciteti prodhues i asetit;
- c) Dokumentacioni për gjendjen teknike të asetit, rendimentin e prodhimit, specifikimet e lëndës djegëse, konsumin nominal dhe treguesit e ndotjes mjedisore;
- ç) Garancia për aftësinë gjeneruese të sigurt dhe pa ndërprerje të asetit;
- d) Deklarata për rendimentin në prodhim të asetit gjenerues të ofruar;
- dh) Deklarata për dhënien e garancisë së lidhjes së asetit në sistemin e transmetimit 220 KV të Republikës së Shqipërisë.

15. Shoqëria e prodhimit përcakton në procedurën e qiramarrjes një sistem vlerësimi për ofertën fituese, i cili bazohet kryesisht mbi çmimin më të ulët të qirasë së ofruar si dhe, ndër të tjera, por pa u kufizuar në:

- a) efikasitetin në gjenerim të asetit;
- b) emetimet e gazrave serë;
- c) kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

16. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertat fituese në faqen zyrtare të internetit.”.

IX. SIGURIMI I ENERGJISË NGA PRODHUESIT VENDAS OSE TË HUAJ TË ENERGJISË

1. Gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, në varësi të sasive të disponueshme, mund të lidhë kontrata për furnizimin me energji elektrike me prodhues vendas ose të huaj të energjisë.

2. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë organizon një procedurë të posaçme konkurruese, me afat të përsheptuar 5-ditor, për sigurimin e sasive të energjisë me afat deri në 2 (dy) vjet. Oferta fituese të shpallen ofertat që përmbajnë uljen më të madhe për njësi nën çmimin e bursës hungareze, sipas profilit të kërkuar. Çmim tavan të jetë çmimi i bursës hungareze, sipas profilit të kërkuar. Shpallet fitues furnizuesi i energjisë që garanton sigurimin e energjisë me çmimin më të ulët.

3. Kriteret kualifikuese të ofertuesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) subjekti ofertues të jetë i pajisur me licencë për prodhimin e tregtimin e energjisë elektrike, të lëshuar nga ERE për ofertuesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo nga shtetet përkatëse për ata ofertues, të cilët janë regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) subjekti ofertues të ofrojë një sigurim bankar oferte sipas kërkesave të procedurës konkurruese, të vlefshme për një periudhë prej të paktën 5 (pesë) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ofertës;

c) subjekti ofertues të ofrojë garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve kontraktore;

ç) subjekti ofertues të depozitojë pasqyrat financiare të vitit të fundit të certifikuara (pozitivisht kalueshëm dhe pa rezervë), sipas rregullave të shtetit përkatës, ku shoqëria ushtron aktivitetin;

d) subjekti ofertues të ketë dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, i cili duhet të vërtetojë që:

- subjekti ofertues nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;

- subjekti ofertues dhe administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen

penalisht për shkelje penale, për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);

- subjekti ofertues ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në rastet kur ofertuesi e ka të pamundur të sigurojë dokumentacionin e lartpërmendur, për shkak të afateve të shkurtra të procedurës së posaçme konkurruese, atëherë njafton një deklaratë me shkrim nga ofertuesi, e cila vërteton të dhënat e kërkuara.

4. Në rast se nuk ka asnjë ofertues që ofron sasi të nevojshme të energjisë edhe pas 2 (dy) thirrjeve të njëpasnjëshme, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë ka të drejtë të hyjë në marrëveshje të drejtpërdrejtë me prodhues vendas ose të huaj, që sigurojnë këtë sasi të energjisë.

X. KONTRATA KUADËR E FURNIZIMIT TË ENERGJISË

1. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë ka të drejtë që të kryejë edhe procedurë konkurrimi për lidhjen e kontratave kuadër, për sigurimin afatgjatë të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë dhe për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu. Marrëveshja kuadër të ketë afat deri në 3 (tre) vjet.

2. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë përllëgarit sasinë e nevojshme të energjisë për periudhën vjetore, sipas nevojave të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, bazuar në skenarët e mundësive të furnizimit nga shoqëria publike e prodhimit të energjisë, si dhe e prodhuesve prioritar të energjisë së rinovueshme.

3. Mbi këtë sasi të energjisë së nevojshme, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë të shpallë procedurën konkurruese për sasinë vjetore të energjisë nga shoqëri vendase apo të huaja. Procedura përcakton që kontrata e furnizimit të jetë për sasi të energjisë së ndryshueshme, sipas profilit me bazë orare, ditore, javore, mujore apo vjetore.

4. Kriteret kualifikuese për shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë konkurruese, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë e pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për ofertuesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo nga shtetet përkatëse për ata ofertues, të cilët janë regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) të ofrojë një sigurim bankar oferte sipas kërkesave të procedurës konkurruese;

c) një angazhim që oferta e tyre të jetë e vlefshme për një periudhë prej të paktën 7 (shtatë) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ofertës;

ç) angazhimin që, në rast se ofertuesi do të përzgjidhet si ofertues fitues, ky ofertues të lëshojë një garanci bankare kontrate, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë;

d) shoqëria duhet të paraqesë eksperiencën e mëparshme për sigurimin e kësaj sasive energjie në kontrata afatgjata furnizimi në masën 100% të ofertës së bërë.

5. Çdo ofertues oferton vetëm 1 (një) herë.

6. Oferta fituese të shpallen ofertat që përmbajnë shtesën më të ulët për njësi mbi çmimin e bursës hungareze ($\Delta\% * \text{HUPEX}$), e llogaritur sipas profilit të energjisë së kërkuar nga shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, me bazë orare, ditore, javore, mujore apo vjetore.

7. Çdo ofertues duhet të paraqesë ofertën financiare në euro për sasinë e energjisë së ofertuar.

8. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë përcakton mënyrën e bërjes së pagesave për livrimet e energjisë në njoftimin e procedurës konkurruese.

9. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertën fituese në faqen zyrtare të internetit.

XI. TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë dhe shoqëritë KESH sh.a., “OSHEE Group” sh.a. dhe OST sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama